



Shikimi i Allahut në këtë botë dhe në botën tjetër

Description

Gibril F. Haddad

Allahu i Madhëruar i mundësoi Profetit tonë (a.s.) të dëgjonte të folurën e Tij pa pasur ndërmjetës natën e Israsë dhe Musait (a.s.) i mundësoj besëlidhjen pa pasur ndërmjetësues mes tyre, por Profeti ynë u bekua edhe me një mirësi tjetër përveç të dëgjuarit të fjalëve të Allahut, zbulimin e të parit të Zotit.– El-Kushejri.[1]

Një shembull i këtyre ajeteve me dykuptimësi janë gerrat që ndodhen në fillimet e disa sureve. Një shembull tjetër është pohimi i të parit të Allahut përmes syve në botën e përtejme, e ky pohim dallohet qartë nga ajetet eksplicite që ndodhen në tekstin kuranor: **“Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë.”** (Kijame: 22-23). Sepse Ai ekziston me Atributin e përsosmërisë, dhe fakti që Ai mund të shohë Vetveten dhe të shihet edhe nga të tjerë, është pjesë e karakteristikave të përsosmërisë; për më tepër kur besimtari është i prirur që të përfitojë nga kjo dhuratë e Allahut. Gjithsesi të pohuarit e drejtimit se nga do të shihet Allahu është e ndaluar që të tregohet. Është më se e qartë se të pohuarit e mënyrës se si do të shihet Allahu është pjesë e dykuptueshmërisë, dhe është e detyrueshme që të pranohet në heshtje pa shtuar komente të ndryshme për mënyrën se si – El-Pazdaui.[2]

Ibn ‘Abd el-Berr në veprën e tij *al-Intika*’ dhe në veprat e tij të tjera pohon se Imam Maliku dhe Shafiu përmendin si një nga pjesët e besimit të parit e Allahut të Madhërueshëm në botën e përtejme duke përmendur si argument këto ajete: **“Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë.”** (Kijame: 22-23) dhe ajetin **“Jo dhe jo! Atë ditë do të jenë të penguar prej (ta shohin) Zotit të tyre. Pastaj ata do të hyjnë në Xhehenem.”** (Mutafifin:15-16).[3]

Imam Ibn Khafif pohon në veprën e tij *el-‘Akida el-Sahih*a:

30. Besimtarët do të shohin Allahun në Ditën e Ringjalljes ashtu sikurse ata shohin hënën e plotë kur ajo ndodhet në qiell. Atyre nuk do t'u mohohet në mënyrë të padrejtë të parit e Tij.

31. Ata do ta shohin Atë pa pasur nevoja të grumbullohen (ihâta) dhe pa pasur kufij (tahdîd) apo pa ndonjë kufizim kohor (hadd), qoftë kjo e parë nga përpara, pas, sipër, poshtë, nga e majta apo e djathta. ...

97. Shikimi i Tij në këtë botë është i pamundur.

Mutezelitët dhe grupe të tjera si Shi'itët pohojnë se Allahu nuk mund të shihet në tërësinë e Tij, madje as në Ditën e Ringjalljes. Ata mohojnë dhe hadithet e forta, duke pohuar se një shikim i tillë ka nevojë për një drejtim dhe një trup, të cilat nuk janë pjesë e Tij. Nga ana tjetër Ehli Suneti pohon se Allahu do të shihet nga besimtarët e Tij pa pohuar ndonjë prej specifikave, se si do të jetë ky vështrim, duke u argumentuar me ajetin: **“Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë.”** (Kijame: 22-23) dhe me hadithet e shumta që kanë ardhur për këtë çështje dhe që pohojnë se kjo ndodhi është e vërtetë. Eshariu ka hedhur poshtë shumë argumente të Mutezelitëve dhe Shiave për sa i përket pohimeve të tyre, ndërkohë që hanbelitët e hershëm e konsideronin mohimin e të parit të Allahut në botën e përtejme dhe Ditën e Gjykimit si kufër.[4] Në tërësi pjesa më e madhe e dijetarëve të Ehli Sunetit mohojnë ndonjë modalitet kohor, trupëror, drejtim për mënyrën e të parit të Allahut, por nga ana tjetër ata e pohojnë shikimin e Tij, por nuk tregojnë mënyrën se si do të ndodhë kjo. Ndërkohë që Ehli Suneti kanë mendime të ndryshme për sa i përket shikimit të Tij në këtë botë.

El-Kari dhe el-Hajtemi transmetojnë se qëndrimi i përbashkët i Ehli Sunetit është se shikimi i Allahut në këtë botë është i mundshëm, por që nuk mund t'u ketë ndodhur, përveçse profetëve (a.s.) ndërkohë që kemi dy transmetime që nuk përputhen për këtë mesele njëra është e transmetuar nga el-Eshari në el-Kushajri Risala.[5] Prova se shikimi i Tij është i mundshëm edhe në këtë botë ka si argument kërkesën e Musait- Paqja e Zotit qoftë mbi të- që i kërkoj Allahut të Madhërishtëm: **“E kur Musai erdhi në kohën që i caktuam dhe i foli Zoti i vet, ai tha: “Zoti im! Më mundëso pamjen tënde e të shikoj!”** (Arafë: 143) e meqenëse Profetët nuk kërkojnë diçka që nuk lejohet dhe që është e pamundur.[6] Imam el-Kushejriu pohon në Risalen e vet, se shikimi i Allahut në këtë botë nuk mund të ndodhë për askënd përjashtuar këtu Profetët – Paqja e Allahut qofshin mbi to,— ndërkohë që pohimi i vetëm i atyre që nuk pranojnë shikimin e Allahut në këtë botë është ai i el-Dhehebiut.[7] Qëndrimi më i saktë për këtë çështje është ai i Sheh Muhji el-Din ibn ‘Arabi: “Ai mund të shihet me zemër dhe me sy, nëse Ai e dëshiron diçka të tillë.”[8] shumë nga qëndrimet e mësipërme janë bazuar nga transmetime të Profetit a.s: “Në të vërtetë nuk do ta shihni Zotin tuaj derisa të vdisni.”[9] Ibn Haxher transmeton një hadith tjetër: “Adhurojeni Allahun sikurse ta shihni Atë” dhe më tej shton se shikimi i Allahut me sy në këtë botë nuk mund të kryhet, por shton: “Shikimi i Allahut nga Profetët-bekimet e Zotit qofshin mbi ta—mbështeten nga të dhëna të tjera.”[10]

Profeti-Paqja e Zotit qoftë mbi të- e ka parë Allahun para vdekjes së tij [GH1] dhe ky është mendimi i dijetarëve të Ehli Sunetit dhe bazohet në një transmetim të Neveviut, që e transmeton nga el-Kariu.[11] Prova për këtë pohim është edhe hadithi i transmetuar nga Ibn Abasi, në të cilin përcillet se Profeti-Paqja e Zotit qoftë mbi të- ka thënë “Unë e pashë Zotin tim” (ra’aytu rabbi).[12] Ibn Kethiri ka cituar në tefsirin që i ka bërë sures El-Nexhm, ku e ka përmendur si hadith të saktë, por e ka quajtur hadithin si pjesë e ëndrrës që citohet më poshtë. Ibn el-Kajimi [shih pjesën e shënuar më poshtë] na përcjell se Imam Ahmedi e ka konsideruar një shikim të tillë, se ka ndodhur gjatë kohës kur Profeti-paqja e Zotit qoftë mbi të- ka qenë në gjumë, por gjithsesi profeti ka parë Zotin— duke qenë se ëndrrat e Profetit

janë të vërteta – por disa nga ndjekësit e Imamit gabimisht i kanë atribuar Profetit-Paqja e Zotit qoftë mbi të- të parit e Allahut me “sytë e kësaj dynjaje”.[13]

Bejhekiu gjithashtu transmeton hadithin “Unë pashë Zotin tim” në el-Esma’ ua el-Sifat me një zinxhir transmetimi të fortë, por me shtesën: “në formën e një njeriu me flokë kaçurrela, me mjekër si një të riu dhe me një veshje ngjyrë jeshile,” e ky transmetim është i papranuar dhe i shpifur e është i njëjtë me hadithin që i atribuohet Xhibrilit.[14] Ndërkohë që Sujutiu e interpreton këtë hadith si një ëndërr ose përdor dhe citimin e shejhut të tij Ibn al-Humamit, si “*hije e pamjes*” (hijâb al-sûra).[15]

Një shpjegim tjetër është i transmetuar nga El Kariu në shumë komentare të tjerë për këtë hadith dhe të ngjashëm me të, kur Profeti-paqja e Zotit qoftë mbi të- thotë: “Zoti im më është shfaqur në format më të mira” –transmetuesi thotë: “Mendoj se ka thënë: ‘në ëndrrat e mia’” – “dhe ai më pyeti se çfarë ndodhi në Asamblenë e Lartësuar (al-mala’ al-a’lâ)[16] dhe unë i thashë se nuk e dija, kështu që Ai vendosi dorën e Tij mes shpatullave të mia dhe unë ndjeva ftohtësinë në brëndësi dhe arrita të marrë dijen për çdo gjë që ekzistonte nga Lindja në Perëndim.”[17]

El-Mubarekfuri transmeton nga Ibn Kethiri dhe el-Hejtemi mendimin, se vizioni i përmendur më sipër ndodhi kur Profeti-Paqja e Zotit qoftë mbi të- ishte në gjumë. Ky është dhe mendimi i Ibn el-Xhezit i bazuar në këtë hadith, që ka një zinxhir të fortë transmetimi.[18] El-Hejtemi tregon se fjalët “U zgjova dhe pashë Zotin tim” në transmetimin e Ahmedit nga Muadhi dhe në fakt fjalët kanë qenë “Unë po flija dhe pashë Zotin tim”, ndërsa për shkak të ndërhyrjes së një shkruesi “Unë po flija” (istathkaltu) – që ndodhet në transmetimin e Tirmidhiut nga Muadhi kthehet –në “Unë u zgjova” (istajkadhtu).[19] Komenti i të gjithë dijetarëve për sa i përket këtij vizioni qoftë ai i transmetimit që e ka parë në gjumë apo pak para zgjimit të tij komentohet si një shikim me “sytë e zemrës” ose “me sytë e mendjes,” por kjo nuk e ndryshon faktin që ai e ka parë Atë në formën e Tij reale, dhe ëndrra-vizioni i Profetit– Paqja e Allahut qoftë mbi të– është shumë më e fortë se sa vizioni i një njeriu tjetër.

Të shumta kanë qenë dhe interpretimet e hadithit nga ana e dijetarëve të tjerë të Ehli Sunetit. El-Razi, por edhe el-Bejhekiu para tij e kanë interpretuar vendosjen e Dorës së Allahut të Madhëruar si një nderim dhe përkujdesje ndaj Profetit- Paqja e Zotit qoftë mbi të- ose si një pëlqim të Tij ndaj atij, ndërsa vendi në të cilën është vendosur Ajo reflekton derdhjen e mirësisë dhe mëshirës hyjnore në zemrën e tij, ndërsa qetësia e tij reflekton kompletimin dhe perfeksionimin e dijes së tij sikurse tregohet në fjalët e tij “Unë di gjithçka që ndodh mes Lindjes dhe Perëndimit.”[20] El-Kariu shkruan në kapitullin mbi Çallmën e Profetit (a.s.) të librit të tij “Xham’ el-Uasa’il fi Sharh el-Shama’il”, një komentari mbi librin e Tirmidhiut “Shama’il” ose “Karakteristikat e Profetit”:

Profeti-bekimet e Allahut qofshin mbi të- e ka parë Zotin gjatë gjumit apo Allahu i Madhërishëm dhe i Lartësuar e ka treguar veten e Tij në një formë të tillë (bi al-taxhallî al-sûrî), e kjo shfaqje është mjaft e njohur nga mjeshtërit e gradave të shpirtit dhe stadeve të tij (erbâb el-hâl uel-mekâm), dhe kjo ka të bëjë me përkujtimin e natyrës së Tij (hajatihi) dhe reflektimin në vizionin e Tij (ru’jatihi), i cili është fryti i perfeksionimit të vetë-ndarjes dhe të vetë- zbukurimit. Dhe Allahu e di më së miri për sa i përket gjendjeve të Profetit të Tij dhe shokëve të tij, të cilët Ai i ka lartësuar përmes edukimit të Tij, e duke i bërë shembuj ato, zemrat e të cilëve Ai i ka lëmuar vetë Ai, derisa ata dëshmuar për Stadin e Pranisë Hyjnore dhe Qëndrueshmërisë (makâm al-hudûr ua al-bakâ’), dhe e çliruan veten e tyre nga ndryshku që iu kishte zënë zemrën, duke e zhdukur atë (sada’ al-hudhûr uel-fenâ’). Na dhuroftë Allahu neve dëshirën e tyre, na mundësoftë Ai që të shijojmë gjendjen e tyre dhe na bëftë prej pasuesve të zakoneve të tyre, dhe na mundësoftë Ai të vdesim në stadin e dashurisë për to dhe na ringjalltë në një

grup me to.[21]

El-Kariu vazhdon më tej kur citon një transmetim të Ibn Kajimit, i cili përcjell nga Ibn Tejmija, se kur Profeti-begatitë e Zotit qofshin mbi të- pa Zotin e tij të vendoste dorën e Tij mes shpatullave të tij, ai e nderoi këtë pjesë me fundin e çallmës së tij.[22] Diku tjetër ai përmend:

Ibn Sadaka transmeton se Ebu Zura është shprehur: ‘Hadithi i Ibn Abasit [për Profetin që ka parë Zotin e tij] është i saktë (sahîh), dhe askush nuk e mohon atë përjashtuar Mutezilitët... Ibn el-Humami ka transmetuar: ‘Kjo nuk është gjë tjetër vetë se një pamje (hijâb al-sûra).’ Ndoshta ai ka dashur të thotë përmes kësaj se i gjithë qëllimi mund të kuptohet vetëm pasi ai të interpretohet si një shfaqje figurative (taxhallî sûrî), duke qenë se është absurde të interpretuarit e saj, si një shfaqje në kuptimin e fjalëpërfjalshëm të saj (taxhallî hakikî). Allahu i Lartësuar ka shumë mënyra të shfaqjes së Tij (anuâ‘ min al-taxhallijât) e kjo falë Esencës dhe Atributeve që Ai zotëron, meqenëse Ai zotëron fuqitë dhe mundësitë për ta shfaqur veten e Tij në të gjithë mundësitë e mundshme. Por ndërkohë Ai është transcendent dhe nuk zotëron asnjë trup (xhism), formë (sûra), dhe drejtim (xhîhât) me respekt ndaj Qenies së Tij. Këto konsiderata na ndihmojnë që të zgjidhim shumë prej vështirësive në ambiguitetin e ajeteve dhe të transmetimeve të Atributeve. Allahu e di më së miri realitetin e shpirtave dhe imtësitë e sendeve. Nëse hadithi ka diçka në zinxhirin e tij të transmetimit, atëherë kjo është diçka për t’u shqyrtuar, përndryshe, dera e interpretimit figurativ është e hapur (bâb al-ta’uîl uâsi’un muhattam).[23]

Diku tjetër el-Kariu pohon:

Nëse ky vizion ka ndodhur në një ëndërr, atëherë nuk ka asnjë vështirësi. Gjithsesi nëse ka ndodhur kur Profeti ka qenë zgjuar (fil jakdha), sikurse pohon Ahmed Ibn Hanbeli në transmetimin e tij [por shih el-Hajtemin dhe komentin e tij të mësipërm], atëherë Selefët e deklaruan besimin e këtij transmetimi-pasi e provuan që ai ishte një transmetim i saktë-të pa komentueshëm në formën që mund të komentohen atributet e krijesave. Ata gjithashtu ndaluan dhe modalitetin (el-kejfijja) dhe të besuarin e të kuptuarit të kuptimeve të fshehta të Allahut. Duke qenë se Ai i tregonte Profetit-begatitë e Tij qofshin mbi të- gjithçka që ai dëshironte nga perdja e të Padukshmes, duke përfshirë edhe atë çka mendja jonë e ka të pamundur për ta kuptuar. Gjithsesi duke lënë anash interpretimin figurativ (et-te’uîl) në kohët tona po ushqehet konfuzioni (fitneja) në besimin e njerëzve, përmes përhapjes së shumë doktrinave keqduhëzuese (i’tikâdât el-dalâl). Prandaj është më mirë që të interpretohet ky hadith në konformitet me Ligjin dhe të shikohet si një interpretim i mundshëm dhe jo si i vetmi. Në këtë mënyrë fjala “në formën më të saktë” mund të komentohet “e pashë Zotin tim duke qenë unë në formën më të mirë në kuptimin më të plotë të kënaqësisë dhe mirësisë së Tij kundrejt meje”; ose “në formën më të mirë të Zotit” në kuptimin që forma e Tij ishte e dallueshme nga format e tjera, duke qenë se i përket si formë zotëruesit të tij, apo është pjesë që e karakterizon atë. Kjo mund t’i atribuohet kuptimeve ashtu edhe trupave materialë. Pra, kur dikush flet për “pikturimin e një situatë të atillë”. “Forma” e Allahut të Madhërueshëm-dhe Allahu e di më së miri-do të ishte Esenca e Tij specifike (dhâtuhu el-mekhsûsa) e ndarë nga ndonjë paraqitje në formën e Tij të plotë dhe perfekte, ose një Atribut që është specifik për Të, që do të thotë ‘Zoti im ishte më i dashur dhe më i këndshëm se çdo herë tjetër.’ Kështu e transmeton el-Tibi dhe el-Turibishti atë.[24]

Ajo çka shpjeguar më sipër na kujton interpretimet e Neveviut dhe Ibn Xheziut, përkatësisht në Sharh Sahih Muslim[25] dhe në hadithin e dytë të Daf Shubah al-Tashbih:

Nëse themi se Profeti-Allahu e begatoftë atë- e pa Atë ndërsa ishte zgjuar, atëherë forma, nëse ne po flasim për Allahun e Madhërishëm, ka kuptimin e mëposhtëm: “E pashë Atë në Formën e Tij më të bukur duke m’u shfaqur mua dhe duke më kënaqur mua me atë shfaqje”

Nëse themi se kjo i referohet Profetit-Allahu e begatoftë dhe e mëshiroftë- atëherë kjo do të thotë “E pashë atë duke qenë unë në trajtën më të mirë.”[26]

Të tjerë e konsiderojnë transmetimin e Ibn Abasit, si një transmetim që flet për një vizion ku profeti e ka parë me sytë e zemrës, sikurse është sqaruar në disa transmetime të tjera të Ibn Abasi në Sahihun e Muslimit dhe Sahihun e Tirmidhiut, transmetime që janë hasen: “Ai e pa Atë me zemrën e tij.” Një transmetim tjetër nga Ibn Abasi, që gjendet tek Muslimi pohon: “Ai e pa me zemrën e tij dy herë,…” dhe ky është koment i ajeteve: **“Zemra nuk mohoi atë që pa (me sy). A po i bëni polemikë atij për atë që ka parë? Atë(Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër.”** (Nexhm: 11-13)

Një shpjegim tjetër është se Profeti-Allahu e begatoftë dhe e lartësoftë- pa dritën. E kjo përforcohet në formën eksplicite, kur Profeti-paqja e Zotit qoftë mbi të-i përgjigjet pyetjes së Ebu Dherrit, nëse ai e ka parë Zotin: “Unë pashë dritën.”[27]

Shumë transmetime të forta tregojnë se Sahabët kanë pasur mendime të ndryshme për sa i përket shikimit të Allahut nga ana e Profetit-Allahu e mëshiroftë dhe e begatoftë. Ibn Abasi na përcjell se ai e ka parë, ndërsa Ibn Mesudi, Aisha, Ebu Hurejra dhe Ebu Dherri transmetojnë të kundërtën, duke pohuar se ajeti i sures Nexhm dhe ajete të tjera të sureve të ndryshme i referohen shikimit të Xhibrilin nga ana e tij,[28] pra, se Profeti (a.s.) ka parë dritën e tij.

Buhariu përcjell nga Mesruki se ky i fundit ka thënë:

E pyeta një herë Aishen: “O Nëna ime! A e ka parë Muhamedi- begatitë e Allahut qofshin mbi të- Zotin e tij?” Ajo m’u përgjigj: “M’u ngritën flokët përpjetë nga kjo që po më thua. Dije pra, se kushdo që të thotë ty tre gjëra- kushdo qoftë ai po të gënjen- [e para] kushdo që të tregon se Muhamedi-Allahu e begatoftë dhe e mëshiroftë- ka parë Zotin e tij, ka gënjer.” Më pas ajo recitoi: **“Të parët(e njerëzve) nuk mund ta përfshijë Atë, e Ai e përfshin të parët. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur.”** (Enam:103)**“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anën e frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje”** (42:51). “[Së dyti,] Kushdo që të tregon ty se e di se çfarë do të ndodhi nesër, po të gënjen.” Më pas më recitoj: **“nuk e di kush pos Tij se çka do t’i ndodhë”** (31:34). “Dhe [së treti,] kushdo që të thotë se ai ka fshehur diçka, është duke të gënjer.” Më pas më recitoi: **“O ti i dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revalatën-risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon.”** (5:67) “Gjithsesi ai e ka parë dy herë Xhibrilin në formën e tij reale.”

Ky hadith është transmetuar edhe nga Mesruku dhe nga Muslimi në këtë formë:

Unë isha ulur në shtëpinë e Aishes dhe ajo më tha: “O Ebu Aisha [pra, Masruk], ka tre gjëra që kur dikush t’i thotë, atëherë po të gënjen në mënyrën më të turpshme për Allahun.” Unë e pyeta: “Kush janë këto?” Ajo m’u përgjigj: “[e para] kushdo që ju thotë se Muhamedi-Begatitë e Allahut qofshin mbi të- ka parë Zotin e tij, ai po gënjen për Allahun në formën më të ulët dhe të urryer.” Pasi ajo më tha këto fjalë unë u ngrita në këmbë dhe i thashë: “O Nëna e besimtarëve! Më jep pak kohë dhe mos më ngut. A nuk ka thënë Allahu i Madhëruar: **“Dhe se ai e pat parë atë në horizontin e qartë lindor .”** (81:23), **“Atë e ka parë edhe herën tjetër”** (53:13)?” Ajo iu përgjigj: “Unë kam qenë e para nga i gjithë Umeti, që e kam pyetur Muhamedin-Begatitë e Zotit qofshin mbi të- për sa i përket këtyre ajeteve, dhe ai më tha: “Kjo është për Xhibrilin e unë e kam parë atë vetëm dy herë në formën e tij të vërtetë. E kam parë atë duke zbritur nga qielli, ndërkohë që e mbulonte të gjithë atë. Gjatësia e

shpatullave të tij ishte sa distanca mes qiejve dhe tokës.” Më pas ai më tha: “A nuk e ke dëgjuar Allahun: **“Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshijë Atë, e Ai e përfshin të parët. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur.”**(6:103)? A nuk e ke dëgjuar kur Allahu thotë: **“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anën e frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai. Vërtet, Ai është më i larti, më i urti.”** (42:51)?” Ajo vazhdoi: “[Së dyti,] Kushdo që pohon se i Dërguari i Allahut ka fshehur diçka nga libri i Allahut, ka gënjyer në mënyrën më të turpshme, meqenëse Allahu thotë: **“O ti i dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revalatën-risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon.”** (5:67).” Ajo vazhdoi: “[Së treti] kushdo që pohon se mund të parashikojë të ardhmen, ai është duke gënjyer për Allahun në formën më të turpshme dhe të ulët, meqenëse Allahu thotë **“Thuaj: “Askush veç Allahut as në qiejt, as në tokë nuk e di të fshehtë, as nuk e din se kur ringjallen!”** (27:65).”[29]

Muslimi shton dhe një fjalë tjetër:

Ajo tha: “Nëse Muhamedi-begatitë e Allahut qofshin mbi të- do të fshihte diçka nga ajo që i është zbritur ai do të fshihte edhe këtë ajet: **“Kur i the atij që Allahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: “Mbaje bashkëshorten tënde dhe kij frikë na Allahu!”**, e ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që Allahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t’i frikësohesh Allahut. E pasi që Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, **Ne ta kurorëzuar ty atë, e për të mos pasur besimtarët vështirësi (mëkat) në martesë me gratë e të adoptuarëve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i Allahut është kryer.**” (33:37).”

Një transmetim nga Tirmidhiu nga el-Shabiu citon dy mendime për sa i përket këtij konteksti:

Ibn Abasi ka takuar Kabin [al-Ahbar] në Arafat dhe e pyeti atë për diçka, ndërsa Kabi filloj të bërtitste Allahu Ekber! Derisa malet iu përgjigjën atij. Ibn Abasi i tha: “Ne jemi Benu Hashim!”[30] Kabi tha: “Allahu i Madhërishëm e ka ndarë shikimin e Tij dhe të folurën e Tij mes Muhamedit-begatitë e Tij qofshin mbi të- dhe Musait-begatitë e Allahut qofshin mbi të gjithashtu. Musait i ka folur dy herë, ndërsa Muhamedi e ka parë atë dy herë.” Masruku transmeton: “Më vonë [31] unë shkova të vizitoj Aishen dhe e pyeta: ‘A e pa Muhamedin Zotin e tij?’ Ajo m’u përgjigj: ‘Më ke thënë diçka që më ka ngritur qimet përjetë.’ I thashë: ‘Mos u nxito!’ dhe i recitova [ajetet që lidheshin me të][32] ajetet **“Ai (Muhamedi) vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet**”(53:18). Ajo më tha: ‘Ku po të dërgon e gjitha kjo? Ajo bën fjalë për shikimin e Xhibrilit. Kushdo që të thotë se Muhamedi-Allahu e begatoftë- ka parë Allahun, apo ka fshehur diçka nga shpallja, apo se pohon se ai ka njohur pesë gjërat me të cilat Allahu i di të fshehtat **“S’ka dyshim se vetëm Allahu e di kur do të ndodhë kijameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se çka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se çka do t’i ndodhë (çka do të punojë) nesër, dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i dijsmi, më i njohuri.**” (31:34) – ai të ka gënjyer. Ndërkohë që ai e ka parë Xhibrilin disa herë dhe vetëm dy herë në formën e tij të vërtetë: një herë tek pema e fundit në sidretu el-muntaha, dhe një herë në Xhijad [Meke], me të gjashtëqind krahët e tij, me të cilët ai e mbushi kupën qiellore.”

Ibn el-Kajimi në veprën e tij Zad al-Me’ad thotë:

Sahabët kanë patur mendime të ndryshme për sa i përket shikimit të Allahut nga ana e Profetit-paqja e

Allahut qoftë mbi të- e nëse ai e ka parë atë natë (në natën e Israsë dhe të Miraxhit) apo jo. Është transmetuar në mënyrë autentike nga Ibn Abasi se Profeti-Allahu e begatoftë-e pa Zotin e tij, dhe po kështu autentik është dhe transmetimi tjetër i Ibn Abasit që thotë: “Ai e pa Atë me zemrën e tij.” Na është përcjellur nga Aisha dhe Ibn Mesudi, se ato e kanë mohuar një shikimit të tillë, duke recituar fjalët e të Madhërishmit “**Atë(Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër, (E ka parë) tek Sidretul Munteha** (Nexhm:13-14) duke iu referuar Xhibrilit.[33] Na përcillet nga një zinxhir transmetimi i saktë një hadith nga Ebu Dherri, kur ky i fundit e pyeti Profetin-paqja e Zotit qoftë mbi të- “A e ke parë Zotin tënd?” dhe ai i përgjigjet: “[Ishte një] dritë e shkëlqyeshme, si mund ta shihja Atë?” (nûrun enne erâh?). kështu që; drita u vendos mes meje dhe të shikuarit e Tij, sikurse citohet dhe tek fjalët: “Unë pashë dritën” (raejtu nûren).[34] ‘Osman ibn Said Darimiu ka përcjellë, se Sahabët kanë rënë dakord, se Profeti-Allahu e begatoftë- nuk e ka parë Atë.[35] Shejhul Islam Ibn Tejmija, Allahu e mëshiroftë dhe ia shenjtëroftë shpirtin! –është shprehur:

Transmetimi i Ibn Abasit se “Ai e pa Atë” nuk kundërshton thënien, e as pohimin e tij se “Ai e pa Atë me zemrën e tij.”, sepse është përcjellë nga Profeti-Allahu e begatoftë- se ka thënë: “E pashë Zotin tim-madhëruar qoftë Ai!”[36] Gjithsesi kjo nuk ka ndodhur gjatë Israsë, por në Medine, kur Profeti ishte i zënë dhe nuk mund të ishte me sahabët gjatë faljes së namazit, pas të cilit i tha atyre se kishte patur një vizion të Allahut gjatë gjumit të tij atë natë. Mbi këtë provë është bazuar Imam Ahmedi kur ka thënë: “Po, ai e pa Atë në të vërtetë (na’am ra’âhu hakkan), sepse ëndrra dhe vizioni i Profetit janë të vërteta.” Kjo është shumë e vërtetë, por Ahmedi nuk ka pohuar, se e pa Atë me sytë e tij të kokës, ndërsa ishte zgjuar. Kushdo që pohon se ai e ka parë në atë formë, ai gabohet. Ahmedi ka thënë një herë: “Ai e pa Atë” dhe më pas tha: “Ai e pa me sytë e zemrës Atë.” Këto janë dy transmetim të përcjella prej tij në këtë mesele. Pohimi i tretë është përmes të cilit ai thotë “Ai e pa Atë përmes syve të mendjes” vjen si një shtesë e disa prej shokëve të tij, meqenëse ne kemi tekste të Ahmedit dhe nuk gjejmë asnjë të tillë.[37]

Ibn Abd el-Selami thotë në Fetvanë e tij:

Përsa i përket shikimit të Allahut të Madhëruar në botën e përtejme, Ai do të shihet bashkë me dritën që Ai ka krijuar dhe do të shihet me sy përmes dritës së dijes. Sepse shikimi na tregon atë që dija nuk na e tregon dot, dhe nëse Zoti i Madhëruar dëshiron të krijojë një dritë në zemër ashtu sikundër ka krijuar dritën e zemrës, kështu që ne mund ta shikojmë Atë, nuk do të ishte e vështirë për Të. E as nuk do ishte e vështirë nëse Ai do të dëshironte të krijonte dritën e zemrës, atë të syve, duarve, këmbëve dhe thonjve, sepse asgjë nuk do të ishte e vështirë për Të![38]

Ibn Haxheri e analizon shumë gjerë këtë mesele në punën e tij [39] dhe ka pëpiluar një monografi mbi këtë temë, duke e titulluar “el-Ghunja fi el-Ru’ja.”[40] El-Kariu gjithashtu i jep një hapësirë të veçantë këtij diskutimi në veprën e tij el-Mirkat.[41]

Përktheu:

Xhodi Hysa

Referenca

[1]In Lata'if al-Isharat (5:152).

[2]Al-Pazdaui in 'Ala' al-Din al-Bukhari's komentar mbi Usulin el-Pazdaui titulluar Kashf al-Asrar (1:55-60).

[3]shih. Ibn 'Abd al-Barr, al-Intiqā' (fq. 73, 145-136). Përkthimi i kuptimeve të Kuranit, si i Pikthollit dhe ai i Jusuf Aliut e mohojnë të kuptuarit e shikimit të Allahut

[4]Shih Tabakat el-Hanabila (1:59, 1:161, 1:312).

[5] El-Kari, el-Mirkat (1892 ed. 5:303); el-Hajtami, Fataua Hadithija (fq. 147-150). Në letër thuhet (fq. 150): "Nëse është e vërtetë që Eshariu ka mbështetur mendimin se shikimi ka ndodhur në këtë dynja, atëherë ai nuk ka qenë në dijeni të konsensusit të Dijetarëve për sa i përket kësaj meseleje dhe prandaj mendimi i tij është jo i saktë (shâhdh) dhe për këtë arsye nuk mund të merret në konsideratë." Në veprën e tij Kitab al-Ru'ja al-Kabir, Eshariu nuk pohon se shikimi mund të ketë ndodhur, por ama mbron hipotezën që Xhumhûr mund të ndodhë.

[6] Sikurse është cituar nga Imam Haremejni në El-Irshad (fq. 169).

[7] Tek Sijar (8:430-431).

[8] Tek Al -Futuhāt al-Makkija (1:164 §142).

[9] Transmetuar nga Ebu Umama ibn el Samit el Bahili, si pjesë e një hadithi të gjatë e transmetuar nga Ahmedit me një zinxhir të fortë transmetimi, sikurse citon el Zajn në Musnedin e tij (16:415 #22663), Ibn Maxhah, el-Nasa'i në el-Sunan al-Kubra (4:419 #7764), al-Hakim (4:456) citon se ky hadith është sahih dhe Dhehebiu e forcon këtë, Ibn Abi 'Asim në veprën e tij al-Ahad ua al-Mathani (2:446 #1249) dhe al-Sunna (p. 186-187 #429) e transmeton me një zinxhir të fortë transmetimi sikurse citohet nga Albani, Ajurri në El Sharia dhe Ibn Huzejme në el-Teuhid. Është transmetuar edhe nga Sahabët në Sahihun e Muslimit, Tirmidhiut që e kanë deklaruar sahih, ndërsa Ahmedit si të saktë (17:72 #23562), dhe Ibn Abi 'Asim në el-Sunna (p. 187 #430) me një zinxhir të fortë.

[10] Në Fath al-Bari (1959 ed. 1:125 #50).

[11] Në al-Mirqat (1892 ed. 5:308).

[12] Transmetuar nga Ahmedit përmes dy zinxhirëve të transmetimit, ku një është i fortë, dhe Axhurri me një zinxhir të fortë transmetimi dhe kjo është vërtetuar nga botuesit e këtij Musnedi (3:165 #2580, 3:184 #2634) dhe i njëjti mendim është dhe i al-Shari'a (p. 495 #1047) sikurse dhe i Hejthemit (1:78-79). Transmetohet po kështu dhe nga Ibn Abi 'Asim në el-Sunna (p. 188 #433) me të njëjtin zinxhir transmetimi, sikurse ai hadithi i dytë i imam Ahmedit dhe Ebu Zuri e ka konsideruar këtë hadith si të fortë në veprën e tij Tabakat al-Hanabila (1:312, 1:242), al-Sujuti tek al-La'ali' (1:29-30), dhe al-Diya' al-Maqdisi tek al-Mukhtara (1:79 #66).

[13] Ibn Kajimi, *Zad al-Ma'ad* (3:34). Përsa i përket ndryshimeve mes ëndrrave të Profetit dhe të tjera shih al-'Iraqi, *Tarh al-Tathrib* (4:180-184, 8:204-220).

[14] AS (p. 444-445), ASH (2:363-364 #938). Një transmetim munker sipas Imam Ahmedit, që transmetohet dhe nga Dhehebiu si i tillë në veprën e tij *Tartib al-Ma'edu'at* (p. 22 #22), sipas al-Ahdab in *Zaua'id Tarikh Baghdad* (8:37-40 #1662). Ibn Xheuzi në *Daf' Shubah al-Tashbih* (1998 al-Kauthari fq. 34) pohon se hadithi është i transmetuar nga Hamad ibn Selami (që është një problem) dhe nga djali i tij i birësuar zindiku Ibn Abi al-'Auja, i cili ka ndërhyrë në të duke e transformuar hadithin. Dhehebiu pohon se ky është një hadith munker në *Sijar* (8:430-431), gjithsesi ai e quan të dobët gjithë entitetin e këtij transmetimi në këtë kapitull.

[15] Në al-La'ali' (1:29-30).

[16] P.sh. "engjëjt erdhën pranë" sipas Ibn al-Ethir në veprën e tij al-Nihaja dhe të tjerat.

[17] Transmetuar nga Tirmidhiu me tre zinxhirë transmetimi, të gjithë janë sahih sipas Albanit: dy janë nga Ibn Abasi – në të parën prej të cilave ai thotë "dija e gjithçkaje në qiell e tokë", ndërsa ai e ka cilësuar të dytin hasen garîb – dhe një zinxhir i cili vjen nga Muadhi (hasan sahîh), i cili pohon në mënyrë eksplicite, se kjo ka ndodhur në gjumin e Profetit. Buhariu deklaron këtë të fundit si një zinxhir transmetimi sahih, sikurse e pohon dhe Tirmidhiu në *Sunenin* e tij 'Ilal, në fakt nuk ka ndonjë mospërputhje mendimesh mes dijetarëve për këtë tekst (shih. ASH 2:78). Gjithashtu e transmeton dhe Ahmedi në katër zinxhirë transmetimi sipas Shakir dhe el Zejnit: një nga Ibn Abasi me fjalët "Mendoj se ai ka thënë "në gjumë të thellë"" (3:458 #3484); një nga Muadhi për të cilin Ahmedi e deklaron në mënyrë eksplicite si sahih, siç transmeton dhe Ibn Adiu në *El-Kamil* (6:2244), me fjalët: "U zgjova nga gjumi dhe isha me Zotin tim!" (16:200 #22008); dhe dy transmetime nga dy sahabë që nuk përmenden dhe që transmetojnë se Profeti ishte në gjumë (13:93-94 #16574, 16:556 #23103). El-Hejthemihon pohon se transmetimi i fundit është më i dëgjuar se sa transmetimet e tjera të Taberanit në al-Kabir (20:109 #216, 20:141 #290) dhe Bezari në *Musnedin* e tij, dhe ai ka deklaruar se zinxhiri i transmetuar nga Ebu Umame nga Taberani në al-Kabir (8:290 #8117) është i saktë. Shih Maxhma' el-Zaua'id (7:176-179). Sheh Abd el-Kadir dhe Sheh Shuaib Arnauti e kanë deklaruar këtë hadith si sahih në shtatë transmetimet e Tirmidhiut dhe Ahmedit në botimin e tyre të veprës së Ibn Kajimit *Zad al-Ma'ad* (3:33-34 n. 4). Transmetohet po ashtu nga Xhabir ibn Samura (p. 203 #465) me një zinxhir të pastër transmetimi sipas Albanit. Po kështu është transmetuar nga 'Abdel-Rahman ibn Aishi, nga Darimiu në *Musnedin* e tij (2:170 #2149) dhe nga Taberani përmes dy zinxhirëve në el-Ehad ua el-Mathani (5:48-50 #2585-2586) dhe një tjetër në *Musnedin* e el-Shamijin (1:339 #597), dhe nga Umm al-Tufajl nga Taberani në veprën e tij el-Ehad (6:158 #3385). Zinxhiri i mëvonshëm pohon: "E pashë Zotin tim në formën e Tij më të lartë si një djalë i ri me mjekër" dhe ky transmetim është mohuar nga Dhehebiu në veprën e tij *Tahdhib el-Maudu'at* (p. 22 #22). Po kështu është transmetuar nga sahabi Ebu Rafi [al-Isaba 7:134 #9875], nga Taberani në veprën e tij el-Kebir (1:317 #938). Po kështu e transmetuar nga Ibn Abasi dhe nga Ebu Jala në *Musnedin* e tij (4:475 #2608). Disa transmetime të sakta të këtij hadithi të tilla si ai i Taberanit nga 'Abd ul-Rahman ibn 'Ejash dhe el-Khatibit nga Ebu 'Ubejde ibn Xherrahu në veprën e tij *Tarikh Baghdad* (8:151) – kanë këto fjalë: "pashë Zotin tim" në vend të fjalisë "Zoti im erdhi tek unë," sikurse është cituar dhe konkluzioni i Ibn Kethirit më sipër. El-Ahdabi në veprën e tij *Zaua'id Tarikh Baghdad* (6:251-253) dhe Hejtemi po kështu citon Ebu 'Ubejde ibn Xherrahun, Ibn Omerin, Ebu Hurejren, Enesin, Theubanin dhe Ebu Umamen, të cilët e çojnë në njëmbëdhjetë numrin e sahabëve transmetues të këtij hadithi përpos Ummu Tufejlit Zinxhirët e transmetimit të këtij hadithi janë marrë

nën shqyrtim dhe u është bërë një kritikë nga Ibn Rexhebi në monografinë e tij *Ikhtijar el-Aula fi Sharh Hadith Ikhtisam el-Mala' el-A'la*, botuar nga Jasim al-Dausari (Kuvait: Dar el-Aksa, 1406). Shih po ashtu dhe veprën e: Ibn Ethir, *Xhami' el-Usul* (9:548-550). Mes atyre që e konsiderojnë këtë hadith si një gradë poshtë sahihut janë Bejhekiu në veprën e tij *el-Asma' ua el-Sifat* (AS p. 300, ASH 2:72-79), Ibn el-Xheuzi në veprën e tij *el-'Ilal el-Mutanahija* (1:34), Ibn Huzejme në veprën e tij *el-Teuhid* (p. 214-221) dhe el-Darekutni në veprën e tij *'Ilal'* (6:56). Disa dijetarë të tjerë kanë shkuar më tej duke e quajtur këtë hadith si të shpikur dhe të fabrikuar: për më tepër shihni el-Sakaf, *Akual el-Huffaz el-Manthura li Bajan Uad' Hadith Ra'ajtu Rabi fi Ahsani Sura*, po kështu dhe botimin e Ibn el-Xheuzi *Daf' Shubah al-Tashbih*.

[18] në veprën *Daf' Shubah al-Tashbih* (Kaëthari ed. fq. 32).

[19] në veprën *Al-Mubarakfuri Tuhfa al-Ahëadhi* (9:74).

[20] El-Razi, *Asas al-Taqdis*, sikurse është cituar nga el-Keutheri në veprën e tij *Daf' Shubah al-Tashbih* (fq. 32-33 n.). shih dhe. el-Bajhaki, *el-Esma' ua el-Sifat* (fq. 300-301).

[21] El-Kari, *Xhem' el-Uasa'il* (fq. 209).

[22] Ibn Omeri transmeton: “Profeti – Paqja dhe begatitë e Zotit qofshin mbi të- “Zakonisht e rrotullonte çallmën rreth kokës dhe e paloste mbrapa, duke e lënë fundin e saj t'i bjerë mbi shpatullat e tij.” E përcjellë nga Bejhekiu në veprën e tij *Shu'ab al-Iman* (5:174) dhe Taberani në veprën e tij *el-Eusat me një zinxhir të mirë transmetimi*, sikurse e përcakton dhe Hejthemi (5:120). Shih dhe Taberani, *el-Kebir* (12:379 #13405) dhe *el-Eusat* (1:227 #344).

[23] el-Kariu, *el-Asrar el-Marfu'a* (2nd ed. p. 209-210 #209; 1st ed. p. 126 #478).

[24] El-Kariu, *el-Mirkat* (1892 ed. 5:303). El-Mubarakfuri në veprën e tij *Tuhfa el-Ahuadhi* (9:73-74) mohon fjalët e El-Kariut, që flasin “për të lënë mënjanë interpretimin figurativ, meqenëse në kohët tona janë përhapur shumë doktrina, që sjellin udhëzim në rrugë të keqe” dhe kjo është në kundërshtim me rrugën e ndjekur nga Selefët një provë që El –Mubarekfuri ishte një literalist. El-Shatibiu ka shkruar në veprën e tij *el-Muuafakat* (2:332): “Dijetarët Suni që ndjekin mendimin e Imam Malikut [duke e urreyer kelamin], përjashtojnë rastin kur dikush është i detyruar të flasë për të. Pra, në momentet kur duhet të mohojë gënjeshtëritë dhe udhëzimin në udhë të gabuar nuk duhet qëndruar i heshtur, por duhet folur në mënyrë që të shmangët udhëzimi në rrugë të gabuar apo nga rreziqe të tilla.”

[25] [Për sa i përket 'formës' dhe shikimit të Allahut në hadithin e njëjtë të Ebu Hurejres:] “Pra, ajo çka është nënkuptuar me “formën” (al-sûra) në këtë moment është atribut i ndjesisë se Allahu ua manifeston Vetën (jetexhela) atyre, në atributet të cilat ato i njohin dhe përmes të cilave ato e njohin Atë. Sepse ato mund ta njohin Atë përmes Atributeve të Tij, edhe nëse ato s'e kanë parë kurrë Atë më parë – I lartësuar qoftë Ai! – po kështu ato do të shohin dhe do të kuptojnë se Ai si përngjason askujt dhe asgjëje nga krijesat e Tij– kështu që ato do të kuptojnë që Ai është Zoti dhe Krijuesi i tyre dhe do të thonë: ‘Ti je Zoti ynë!’ Kështu që fjala “atribut” është shprehur në formën e fjalës “formë” jashtë logjikës së ngjashmërisë (mushâbaha) dhe përngjashmërisë në të folur (muxhënese el-kelâm), sikurse u sqarua më sipër.” Neveviu, *Sherh Sahih Muslim* (3:20).

[26] Ibn el-Xheuzi, *Daf' Shubah al-Tashbih* (Kaëthari ed. p. 32).

[27] Transmetuar nga Muslimi, Tirmidhiu (hasen) dhe Ahmedi përmes katër zinxhirëve të transmetimit.

[28] Sikurse është cituar nga Ibn Kajimi në veprën e tij *Zade I Ma'ad* (3:34).

[29] Shihni po ashtu dhe transmetimin e Masruk nga Tirmidhiu (hasen sahîh).

[30] El-Tibi ka transmetuar: “[Ibn ‘Abas ka thënë] kjo ishte për ta qetësuar atë dhe për të ndaluar irritimin e tij dhe mbi përgjigje u reflektua kuptimi “Ne jemi njerëz të dijes dhe shkencës, ne nuk pyesim për gjëra të cilat nuk mund të kemi njohuri” për shkak të kësaj ai u mendua dhe i ktheu përgjigjen” In al-Mubarakfuri, *Tuhfa al-Ahuadhi* (9:118 #3496).

[31] El-Tibi ka thënë: “Nga këto fjalë mund të kuptojmë, se Masruku ka qenë i pranishëm në momentin që është kryer ndërimi mes Kabit dhe Ibn Abasit.” Në veprën e tij el-Mubarakfuri, *Tuhfa el-Ahuadhi* (9: 119).

[32] Ky shënim është nga el-Tibi, i cili është shprehur: “Është pohuar nga Tirmidhiu në një transmetim tjetër, që thotë: ‘O Nëna e besimtarëve! A mundet të më falësh një moment. A nuk ka thënë Zoti i Gjithëfuqishëm: **“Dhe me të vërtetë ai e pa atë dhe një herë tjetër.”** (53:13), **“Me të vërtetë që ai e pa atë në një shikim të qartë.”** (81:23)?” El-Mubarakfuri e konfirmon El Tibin në veprën e tij *Tuhfa al-Ahuadhi* (9: 119).

[33] Aisha dhe pozicioni i saj janë transmetuar nga Buhariu në katër vende, po kështu janë transmetuar nga Muslimi dhe nga Tirmidhiu, Ibn Mesudi dhe zinxhiri i tij transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi.

[34] Transmetuar nga Muslimi.

[35] Kjo është një kundërthënie e qartë, që transmetohet nga Ibn Abasi, por Ibn Kajimi e mohon atë dhe është në mbrojtje të idesë së Ibn Tejmijes, që pranon pohimin e Darimiut.

[36] Shih më sipër nr. 12.

[37] Në veprën e Ibn Kajimit, *Zad al-Ma'ad* (3:33-34).

[38] Ibn ‘Abdul-Selam, *el-Fataua el-Mausilija* (fq. 106).

[39] Shih. *Fath al-Bari* (1959 ed. 1:125-135 #50, 8:608-610, 11:463-469 #6204) dhe *el-Isaba* (2:405-406).

[40] Kjo është një vepër e përshkruar në mënyrë të shkurtër tek ‘Abd al-Munimi Ibn Hajar (1:267-268).

[41] *Al-Mirkat* (1892 ed. 5:306f.)

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi